



European  
Union  
Kosovo



# 1 Education Comes First

Raporti përmbyllës i projektit  
“Vetëdijesimi dhe promovimi  
i të drejtave të fëmijëve,  
përgjegjësi dhe mbrojtja e  
tyre”



Ojq ECF e realizoi projektin në partneritet me katër shkolla rurale të komunës së Gjakovës. Të përfshirë kanë qenë gjithsej 1441 nxënës, përkatësisht 618 nxënës të Shkollës „Zef Lush Marku“ në Brekoc, 310 nxënës të Shkollës „Ukshin Miftari“ në Skivjan, 273 nxënës të Shkollës „Gjergj Fishta“ në Bishtazhin dhe 240 nxënës të Shkollës „Anton Çeta“ në Dol.

Ky projekt u financua nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Qendra Për Arsim e Kosovës, Forum ZFD dhe Education Comes First



# Aktivitetet e përgjithshme të projektit

1. Krijimi i blogut për të drejtat e fëmijëve;

2. Krijimi i eseve dhe videove nga nxënësit për të drejtat e fëmijëve”

3. Promovimi i blogut në shkolla;

4. Promovimi i blogut në media/rrjete sociale;

5. Aktiviteti "Një Botë pa konflikt" për nxënësit e kl.1- 4, të mësuarit nëpërmjet fotove;

6. "E drejta ime të jetoj pa dhunë" për nxënësit e kl. 5- 9, krijimi i fotove që prezentojnë të drejtat e tyre të jetojnë të lirë dhe në paqe;

7. Përzgjedhja e fotove dhe prezentimi i tyre në Ditën Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve;


8. Konferenca për media në Ditën Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve;

9. Shpërndarja e materialeve promovuese për të drejtat, përgjegjësitë dhe mbrojtjen e fëmijëve;

10. Organizimi i tryezës së rrumbullakët.



<https://tedrejtatefemi.jeve.wordpress.com/>



Ky blog ka për qëllim edukimin e nxënësve për të drejtat e tyre, për të kuptuar se si duhet të trajtohen dhe t'i trajtojnë të tjerët, të nxis krijimtarinë dhe rris vetëdijen.

Blogu është jetësuar me esetë dhe videot e krijuara nga nxënësit të cilët janë përzgjedhur dhe pastaj janë plasuar në platformë.

Ky blog ka për qëllim Informimin, vetëdijësimin për të drejtat e fëmijëve dhe zgjidhjen e konfliktit, edukimi për të drejtat dhe barazinë nëpërmjet platformës elektronike. Ky BLOG do të iu mundësojë nxënësve të shprehin kreativitetin e tyre, të mësojnë dhe të përdorin njohuritë përtej klasës, të bartin në grupet e diskutimit dhe në grupet e lojërave, në shtëpitë e tyre dhe në komunitetin e gjerë.



imi 6.2 Shtetet në fëmijë... për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijë



# NJË BOTË PA KONFLIKT

## Të mësuarit përmes lojës

Një Botë pa konflikt – aktiviteti që u zhvillua në shkollë me nxënësit e kl. 1- 4, të mësuarit nëpërmjet fotove, të mësuarit duke bërë. Aktiviteti/ loja e të gjeturit dy të njëjtave nëpërmjet fotografive dhe interpretimi i tyre nga ana e fëmijëve ka nxitur mënyrën kreative të të menduarit. Aktiviteti ishte i përshtatshëm dhe u kuptua edhe nga nxënësit e klasës së parë të cilët u përfshinë në aktivitetin argëtues por me karakter edukues.

- Aktiviteti u zhvillua në shkollë, ku janë prezentuar foto të fëmijëve në vende të ndryshme të botës që ilustrojnë të drejtat e tyre, dhe zhvillimi i imagjinatës së fëmijëve për të jetuar në një botë në paqe dhe pa dhunë. Fëmijët nëpërmjet lojës kanë eksploruar fotografitë dhe kështu është mundur të mësojnë për të drejtat dhe të diskutojnë.
- Nxënësit janë argëtuar dhe kanë shfaqur interesim për tu përfshirë, duke bërë që secili të merr pjesë në aktivitet.



## Konferenca për ditën ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve

Për ditën ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve, ECF organizoj konferencën, në të cilën morën pjesë përfaqësues të ndryshëm nga ojq-të përfituese të projektit bazë, gjithashtu përfaqësues, drejtor dhe mësimdhënës të shkollave partnere dhe mediat. Në këtë konferencë u diskutua për gjendjen momentale të të drejtave të fëmijëve, eksperiencat, të arriturat dhe vazhdimësinë e projektit në fjalë. Ojq-të e ftuara patën mundësinë të paraqesin përvojat dhe praktikat e tyre të mira. Në këtë konferencë u shfaq ekspozita me fotografi të krijuara nga fëmijët e shkollave partnere.



# Shpërndarja e materialeve sensibilizuese

Në kuadër të këtij projekti shkollat partnere janë pajisur me materiale sensibilizuese për të ndikuar në ngritjen e vetëdijes së fëmijëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Secila shkollë është pajisur me Konventën Për të Drejtat e Fëmijëve dhe të gjithë nxënësit e shkollave kanë marrë broshura vetëdijësuese dhe interaktive, ku kanë mësuar për të drejtat dhe përgjegjësitë nëpërmjet lojërave logjike.



## Vizita studimore

Në kuadër të projektit bazë “Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve” u realizuan vizita studimore në vendet e rajonit, në Shqipëri dhe në Maqedoni.

Qëllimi i këtyre vizitave ishte që pjesëmarrësit të njihen me rëndësinë e klubeve të ndërmjetsimit të këtyre vendeve, pasi shkollat e vizituara janë shembull i mirë i funksionimit të ndërmjetsimit në mes të bashkëmoshatarëve dhe edukimit paqësor.



